



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 430/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani Kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Avdyl Sopaj kandidatë për deputet për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Suharekë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Avdyl Sopaj kandidatë për deputet për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega, në Suharekë.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 27.06.2014, në ora 13:37 ka pranuar një ankesë nga Avdyl Sopaj kandidatë për deputet për Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e LDK-së, në të cilën ankesë pretendohet se pas publikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ, kishte vërejtur numër më të vogël të votave (82 vota më pak) në komunën e Suharekës. Sipas të dhënave të subjektit të tij në komunën e Suharekës parashtruesi i ankesës pohoi se ka 4761 vota ndërsa në KQZ i figurojnë vetëm 4679 vota. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi procesverbalin e vendvotimeve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, pasi që nga provat e bashkangjitura në ankesë nuk është arritur për tu vërtetuar pretendimet ankimore, andaj ankesa në fjalë vlerësohet si e pabazuar. PZAP- duke u bazuar në Nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet” lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa

Anr. 430/2014 më datën 30.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*